



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**K R U J Ë**

Adresa : Lagjia Nr.1 Krujë

Tel.& Fax 051122440

Nr. 7 Prot.

**Krujë më datë 09.01.2023**

**VENDIM**

**“Për pezullimin e procedurës së rekrutimit për plotësimin e vendit vakant në pozicionin e “Sekretarit gjyqësor”, deri në përfundim të procesit të ristrukturimit”**

Në Krujë sot më dt.09.01.2023, Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, bazuar në Ligjin Nr.98 dt.06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 26 të Vendimit nr.622 datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, në zbatim të Vendimit nr.555 datë “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore”, në lidhje me procedurën e rekrutimit për plotësimin e vendit vakant në pozicionin e “Sekretarit gjyqësor” shpallur me Vendimin nr.264 Prot. datë 14.12.2022 të Këshillit të Gjykatës, në kushtet kur sipas këtij vendimi është vendosur pezullimi i të gjitha procedurave të rekrutimit, për plotësimin e vendeve vakante për të gjitha kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, deri në përfundim të procesit të ristrukturimit:

**VENDOSI**

- Pezullimin e procedurës së rekrutimit për plotësimin e vendit vakant në pozicionin e “Sekretarit gjyqësor” shpallur me Vendimin nr.264 Prot. datë 14.12.2022 të Këshillit të Gjykatës, deri në përfundim të procesit të ristrukturimit.
- Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të gjykatës.
- Ngarkohet kancelari i gjykatës të njoftojë K.L.GJ.-në në lidhje me këtë vendim.
- Krujë më datë 09.01.2023.

**KANCELARI**  
**Argjend QESJA**

**ZV/KRYETARE**  
**Elisabeta GJONI**

**KRYETARE E GJYKATËS**  
**Alma KOLGJOKA**